



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 121/2 Prot.

Vlorë, më 17.01.2020

**VENDIM**

**Nr. 39, datë 17.01.2020**

**PËR**

**ÇELJEN E PROCESIT TË VETËKANDIDIMIT PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË  
ETIKËS NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 44 të ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 28 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Vendimit nr. 3 datë 17. 01. 2020 të Rektoratit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.01.2020

**VENDOSI:**

1. Të miratojë çeljen e procesit të vetëkandidimit për anëtarë të Këshillit të Etikës në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Afatet e dorëzimit të kërkesave individuale janë prej datës 17.01.2020- 24. 01. 2020.
3. Vendimi t'i njoftohet gjithë personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe Këshillit Studentor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

